



Pranimi / Dorezimi / Prilpjen / Prilpjen / Kryesia / Delorsy	21.02.2022	2	viti / viti / year
Organ / Shënjë / Organ / Jednoca / Org / Unit	Titri / Proct / Titri / Proct / Prot No	Shtojta / Prillog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPM/SHCK	906/2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.35/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.2438/219 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 10.01.2022, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.452/2019 të datës 08.08.2019 të parashtruar nga ankuesit dhe kundër organit të punësimit-Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.452/2019 e datës 08.08.2019 e parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit, i punësuar në pozitën Udhëheqës i sektorit të prodhimit sipas ndryshimit të akt emërimit të datës 13.03.2019 në Agjencinë e Regjistrimit Civil/MPB dhe i punësuar sipas ndryshimit të akt emërimit të datës 14.03.2019 i caktuar në pozitën Zyrtar mirëmbajtjes së makinave të prodhimit në Agjencinë e regjistrimit civil/MPB, të cilët kanë kërkuar që të marrin shtesa në pagë, pozita të cilat janë të aprovuara: pozita Udhëheqës i sektorit në prodhimin është e harmonizuar me pozitën Menaxher III, ndërsa pozita Zyrtar i mirëmbajtjes së makinave të prodhimit është e harmonizuar me pozitën teknik i TI duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës me Nr.02/39 të datës 08.10.2008.

Menaxherja e burimeve njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme me datë 10.04.2019 ka bërë kërkesë në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave të institucioneve për shtesë në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare për aprovimin e shtesës në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informative.

Ankuesit me datën 12.06.2019 kanë kërkuar nga zyrtarja e personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme se pse ende nuk po i marrim shtesat, zyrtarja e personelit ju është përgjigjur se ende nuk kemi marrë përgjigje nga Komisionin për shqyrtimin e kërkesave në MAP.

Ankuesit, kundër heshtjes administrative të Komisionin për shqyrtimin e kërkesave në MAP., më datë 08.08.2019 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 3473/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.08.2019, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Me datën 13.08.2019 Ministria e Punëve të Brendshme ka dërguar në Këshill shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 16.09.2019 me numër të protokollit 4335/2019 i ka njoftuar ankuesit për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 08.08.2019 dhe se i ka udhëzuar ankuesit që ti ndjekin më tutje procedurat ligjore. Ankuesit dhe kanë parashtruar padi me datën 21.10.2019 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative kundër heshtjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 10.01.2022 merr Aktgjykimin me numër A.nr.2489/19 me të cilin aktgjykim aprovohet kërkesëpadija e paditësit dhe anulohet akti administrativ (njoftimi) i datës 16.09.2019 dhe e detyron Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të marrë vendim të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 08.08.2019.

Administrimi i Provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.08.2019 me numër protokolli 3473/2019 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimi i aktit të emërimit i datës 13.03.2019, Ndryshimi i aktit të emërimit, Kërkesa e datës 10.04.2019 për aprovimin e shtesave në pagë, Vendimi me Nr.02/39 të datës 08.10.2008, Aneksi I –Lista dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita, Autorizimi i E-mail zyrtar i datës 08.08.2019, Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 15.08.2019 bashkë me shkresat e lëndës dhe E-mail zyrtar i datës 16.07.2019,

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit dhe është e pabazuar, sepse:

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve, të cilët pretendojnë që pas sipas ndryshimit të aktit të emërimit të datës 13.03.2019 në pozitën Udhëheqës i sektorit të prodhimit në Agjencinë e Regjistrimit Civil/MPB dhe i punësuar sipas ndryshimit të aktit të emërimit të datës 14.03.2019 i caktuar në pozitën Zyrtar i mirëmbajtjes së makinave të prodhimit në Agjencinë e Regjistrimit Civil/MPB, kërkojnë nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të provave të cilat i kanë ofruar ankuesit kanë konstatuar se menaxherja e burimeve njerëzore e Ministrisë së



Punëve të Brendshme me datë 10.04.2019 ka bërë kërkesë në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave të institucioneve për shtesë në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare për aprovimin e shtesës në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informative, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Ankuesit përmes ankesës së parashtruar në Këshillë kërkojnë që t'u bëhet pagesa e shtesës në pagë që nga ndryshimi i aktit të emërimit bazuar në Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar vendimet e Qeverisë së Kosovës Nr. 07/29 të datës 31.07.2008 dhe Nr.02/39 të datës 08.10.2008, dhe ka konstatuar se Qeveria ka miratuar pagesën shtesë në paga për kategori të veçanta të profesioneve deficitare respektivisht listën e pozitive dhe shtesave në paga për Teknologji Informative dhe Inxhiniering, duke autorizuar Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave si institucione përgjegjëse për zbatim të këtyre vendimeve.

Bazuar në provat shtesë të dërguara nga Ministria e Punëve të Brendshme me datën 12.01.2021, Kolegji ka konstatuar se Ministri i Administratës Publike bazuar në Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ka themeluar Komisioni për shqyrtimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte të tregut të punës për nëpunësit civil, i cili Komision ka qenë funksional deri me datë 26.02.2018, përkatësisht deri me nxjerrjen e Vendimit Nr. 10/2018 të Ministrisë së Administratës Publike, me të cilin është anuluar vendimi Nr.34/2016 i datës 15.09.2016 mbi themelimin e këtij Komisioni.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesve, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 14 ku përcaktohet se *"Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut"*, dhe nenin 17 ku parashihet se *1. Për pozitat ose llojet e pozitive për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është shumë më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit për ato pozita ose lloje të pozitive nga administrata publike, ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut, e cila mund të paguhet për këto pozita ose lloje të pozitive. 2. Kërkesa për miratimin e kësaj shtese nga Qeveria duhet të bazohet në një analizë, e cila tregon se për këto pozita ose lloje të pozitive: 2.1. çmimi i tregut për aftësitë në fjalë është shumë më i lartë se paga që ofrohet nga Shërbimi Civil; 2.2. përpjekjet për rekrutimin e personelit me pagë të Shërbimit Civil kanë dështuar dhe/ose shkalla e dorëheqjeve është e papranueshme; 2.3. pritet se shtesa do të ndikojë në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit. 3. Kushtet dhe metoda për llogaritjen e shumës së shtesave mbi pagën bazë për kushtet e tregut përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa"*

Po ashtu Rregullorja Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 përcakton se: *"Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut, institucioni duhet t'i ofrojë ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën që përmban: 2.1 Arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut për pozitën përkatëse, së bashku me një analizë, e cila dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, duke përfshirë informata mbi nivelin e pagës që paguhet nga organizatat e tjera në tregun e Kosovës për pozita të ngjashme. 2.2 Listën e pozitive përkatëse, gradat*

dhe numrin e nëpunësve civil për çdo pozitë dhe 2.3 Koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushtet e tregut të punës".

Meqenëse, Qeveria ende nuk ka një vendim lidhur me kompensimin e pagës shtesë për fushën e IT dhe se Komisioni për shqyrtimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte të tregut të punës, nuk është funksional. Andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesve janë të pa bazuara.


Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.35/2022

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI



Kryetari i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesve;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-gjyqtares
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

